



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KOLONJË
KESHILLI I BASHKISË

PROTOKOLLI 8

REND – DITE:

1. Miratimi i Rendit të ditës së Mbledhjes, sipas nenit 53, pika 5, ligji 139/2015.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 28.06.2024 të Këshillit Bashkiak dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga institucioni i prefekturës.
3. **Projekt-Vendimi** “Për miratimin e ndihmës ekonomike familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Qershor 2024, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën deri 6%”.
4. **Projekt-Vendimi** “Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave objekt i ligjit nr.7652 dt 23.12.1992, i ndryshuar dhe ligjit nr.9321, datë 25.11.2004, të cilat kanë mbetur pa u rregjistruar në zvrpp”, vendimit të këshillit të ministrave për “rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore”.
5. **Projekt-Vendimi** “Miratimin e Tavanëve buxhetore përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027 të Bashkisë Kolonjë.”
6. Kërkohet mendimi i Këshillit Bashkiak për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e funizimit me ujë të pijshëm dhe largimin (kanalizime) e ujrave të ndotura

Protokolli i mbajtur sot datë 19.07.2024 në mbledhjen e radhës sipas njoftimit të dhënë në datën 16.07.2024.

Të pranishëm: E. Xhelili, P. Çunge, S. Kodra, Z. Meto, E. Avdi, I. Milo, B. Jashari, A. Tartari, G. Tafili, A. Zeneli, H. Iljazi, T. Çaçani.

Mungon: A. Tartari, I. Hodo, E. Çikopana.

E. Xhelili: Përshëndetje, fillojmë me mbledhjen e radhës, pika e parë e rendit të ditës. Jeni dakort me rendin e ditës?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E. Xhelili: Ka dikush prej jush konflikt interesi me ndonjë nga pikat e rendit të ditës.

A. Zeneli: Me pikën katërt të Rendit të Ditës unë kam konflikt interesi.

E. Xhelili: Z. Alma Zeneli në këtë projekt-vendim nuk ke të drejtë vote.

E. Xhelili: Vazhdojmë me pikën dy të rendit të ditës, për miratimin e proces-verbalit të mbledhjes së datës 28.06.2024 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë dhe njohje me shkresën e zbardhjes së vendimeve nga

institucioni i prefektit.Vendimi nr.61 Për miratimin e ndryshimeve në paketën fiskale 2024 të Bashkisë Kolonjë”, nuk është konfirmuar nga institucioni i prefektit.

Z.Meto: Po vendimi për hapjen e klasës After School në kopështin “Afërdita Kole është miratuar?.

I.Orhanas: Po është vendimi nr 64 dhe është konfirmuar.

E.Xhelili:Jeni dakort me pikën dy të rendit të ditës?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili:Vazhdojmë me piken 3 të rendit të ditës për miratimin e ndihmës ekonomike të familjeve që janë larguar nga sistemi i pikëzimit për muajin Qershor 2024, që nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme nga fondi i kushtezuar për bllok ndihmën deri 6%.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili:Vazhdojmë me piken 4 të rendit të ditës projekt vendimi “Për përfundimin e procedurave të privatizimit të banesave objekt i ligjit nr.7652 dt 23.12.1992, i ndryshuar dhe ligjit nr.9321,datë 25.11.2004, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në ZRVPP”,vendimit të këshillit të ministrave për “rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qënë subjekt i ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyera në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore”.

I.Milo: Kjo më së shumti është një procedurë.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili:Vazhdojmë me piken 5 të rendit të ditës projekt vendimi“Miratimin e Tavanëve buxhetore përfundimtare të Programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027 të Bashkisë Kolonjë.”

I.Milo: Ka diçka të re nga vendimi që u mor mbledhjen e kaluar.

E.Josifi:Nuk ka pasur ndryshime, kjo është Programi Buxhetor Afatmesëm përfundimtar, ndryshime do ketë në qoftë së vjen transferta e re.

Z.Meto: Pas rritjes së pagës do kemi ndryshim.

E.Josifi: Do ndryshojë në varësi të shkresës që do na vijë.

Z.Meto:Pse ka rritje në investime.

E.Josifi: Do të ketë ndryshime tek investimet, ne e kemi prioritet investimin gjithashtu dhe shkresat që ne na vijnë kanë prioritet investimin.Për PBA-në e ardhëshme do të kemi ndryshime.

E.Xhelili:Jeni dakort me projekt vendimin?

Pro 12 Kundër 0 Miratohet

E.Xhelili:Vazhdojmë me piken 6 të rendit të ditës,I Kërkohet mendimi i Këshillit Bashkiak për ndryshimin e tarifave për shërbimin e funizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotur.

I.Milo: U bë një dëgjese publike në pamundësi për të qënë prezent çfarë u fol?

E.Xhelili:Në dëgjese u diskutua për ndryshimin e tarifës së ujit të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura.

H.Iljazi:Që të rritet tarifa duhet të rritet investimi, në fshatin Borovë gjatë asfaltimit të rrugës është dëmtuar kanali I ujërave të zeza, kam njoftuar Administratorin e zonës dhe nuk kam gjetur zgjidhje, mos flas kot përgjegjësin e ujësjellësit nuk e kam njoftuar, ai na është përgjigjur për cdo difekt që kemi pasur.

Z.Meto: Rritje tarife uji nuk duhet të ketë në Kolonjë.

A.Zeneli:Tek Axfensia dhe Unaza e qytetit nuk ka kanalizime .

H.Iljazi :Materiale në ujësjellës mungojnë, nuk kanë fadromë por për ndihmesë ju është gjendur fadroma e Bashkisë që ndihmon vete përgjegjësin , ju duhet dhe nje makinë e saktë, puntorët hapin gropa me krahë.Ne na janë gjendur në cdo kohë.

I.Milo: Rritje tarife uji nuk ka, rritje tarife uji do ketë kur Kolonja të plotësohet me materiale dhe të plotësohet stafi, të zëvendësohen punonjësit që kanë dalë në pension.

H.Iljazi: Ne si qytetarë duam në qytetin tonë investime dhe të zëvendësohen punonjësit që kanë dalë në pension.

E.Jorgji: Do bëhen investime tek ujërat e zeza në qytet dhe nëpër fshatra, ujësjellësi do merret në dorëzim, materiale do sillen dhe për këtë arsye kërkohet për ndryshimin e nivelit të tarifave për shërbimin e funizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura, sepse nuk e përballojmë dot me këtë çmim.

Z.Meto:Investimi kur do të fillojë?


E.Jorgji: Ne presim të fillojë investimi, amortizimi tek ujërat e zeza është mbi 160%, ne për momentin jemi ndërmarrje mirëmbajtje për ujësjellës shërbimi dhe jo qendër investimi.

H.Iljazi:Të plotësohet qyteti me investime dhe më pas të rriten tarifat për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujrave të ndotura.

Proces-Verbali i datë 19.07.2024 është firmosur nga 12 antarë Këshilli.

SEKRETAR I KËSHILLIT

INSUIDA ORHANAS



KRYETAR I KËSHILLIT

ERALDO XHELILI

